- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e Kontrates;
  3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	



**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**  
(në rast BOE): \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Shërbimi</b>	<b>Përshkrimi i shërbimi</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total për shërbim(3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					

<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

---

## Shtojca 5.

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Shërbime të mbikqyrje se punimeve

**Afatet e ekzekutimit:** sipas loteve **Loti I:** “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim pedonale, pistë vrapimi dhe korsi biçikletash në liqenin e Farkës”, 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për të njëjtin objekt. **Loti II:** “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim i mbrojtjes lumore nga erozioni i lumit Tërkuzë”, 19 (nëntëmbëdhjetë) ditë kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për të njëjtin objekt. **Loti III:** “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i Emergjencës Civile Ura e Çerkezit”, 6 (gjashtë) muaj kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për të njëjtin objekt

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

---

## Shtojca 7

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Mbikqyrja e punimeve për 3 objekte të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2021:

- Loti I: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim pedonale, pistë vrapimi dhe korsi biçikletash në liqenin e Farkës”
- Loti II: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim i mbrojtjes lumore nga erozioni i lumit Tërkuzë”
- Loti III: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i Emergjencës Civile Ura e Çerkezit”.

Detyrat: Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit.

Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, në çdo rast, kur gjatë mbikëqyrjes së punimeve, sipas fazave përkatëse, konstaton mospërputhjen e punimeve të kryera me lejen e ndërtimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, urdhëron pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe njofton menjëherë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të bashkisë ku kryhen punimet e ndërtimit dhe autoritetin përgjegjës të planifikimit ose, sipas rastit, edhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.



---

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

### **Loti I: “Ndërtim pedonale, pistë vrapimi dhe korsitë biçikletash në liqenin e Farkës”**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formulari i ofertës sipas Shtojcës 1*
- d. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 8.**

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- a. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit financiare (2019, 2020) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të

Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

*Shëmin: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

- b. Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 2 (dy) viteve të fundit financiare (2019, 2020) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë sa 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).
- c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB). (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazes së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).

## 2.3 Kapaciteti teknik:

### Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë mbikqyrjes, formularin / vërtetimin e vlerësimit për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes/ dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shenohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë mbikqyrjes, vërtetim për realizimin e shërbimit të mbikqyrjesku të shënohet vlera, koha si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

**1.1** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

---

**1.2** Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçensë profesionale** për “**Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi**”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi:

- NP-1 Punime germimi ne toke
- NP-2 Ndërtime civile dhe industriale
- NP-4 Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- NP-5 Punime nentoksore, ura e vepra arti
- NP-8 Ndertime detare dhe punime thellimi ne uje
- NP-11 Ndertime per N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise
- NS-1 Punime per prishjen e ndertimeve
- NS-4 Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese etj
- NS-6 Sinjalistikë rrugore jondriçuese
- NS-8 Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
- NS-9 Punime Strukturore speciale
- NS-14 Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radoitelefoni TV etj
- NS-18 Punime topogjeodezike

*Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

**3.** Operatori ekonomik duhet paraqesë me anë të një deklarate listën e personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.

**4.** Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikqyrjes, të përfshirë në licensën e shoqërisë. Për stafin inxhinierik duhet të paraqiten kontratë pune (e vlefshme), diplomë përkatëse, licensë individuale profesionale si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

- Inxhinier Ndertimi 1(nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik 1 (një)
- Inxhinier Gjeolog 1 (një)
- Arkitekt 1 (një)

5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë ose pajisur me license individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

- inxhinier ndertimi me profilin strukture
- inxhinier ndertimi me profilin infrastrukture

6. Një punësim mesatar i të paktën **15 (pesëmbëdhjetë)** personave, për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave të vërtetuar me;

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

7. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

1 (një) punonjës I pajisur me çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").*

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

a. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

b. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

c. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

---

d. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatën e menaxhimit të energjise ISO 50001-2011 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

***Shënim: Kandidati ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".***

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Shënim: Ne zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: *"Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla",* si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *"Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...",* sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara fazes së nënshkrimit të kontratës duhet t'i dergojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bejë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bërë gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

**Loti II:** “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “**Ndërtim i mbrojtjes lumore nga erozioni i lumit Tërkuzë**”,

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formulari i ofertës sipas Shtojcë 1
- d. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 8.

#### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit financiare (2019, 2020) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

*Shëmin:* Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel”.

- b. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 2 (dy) viteve të fundit financiare (2019, 2020) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë sa 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).
- c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB). (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).

---

## 2.3 Kapaciteti teknik:

### Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë mbikqyrjes, formularin / vërtetimin e vlerësimit për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes/ dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shenohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë mbikqyrjes, vërtetim për realizimin e shërbimit të mbikqyrjesku të shënohet vlera, koha si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

1.1 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.

1.2 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçensë profesionale** për **“Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”**, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi:

- N.P –1 (Punime gërmimi në tokë)
- N.S – 18 (Punime topogjeodezike)

*Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

3. Operatori ekonomik duhet paraqesë me anë të një deklarate listën e personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.

4. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të

gjitha shërbimeve të mbikqyrjes, të përfshirë në licencën e shoqërisë. Për stafin inxhinierik duhet të paraqiten kontratë pune (e vlefshme), diplomë përkatëse, licensë individuale profesionale si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

- 1 (një) inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) inxhinier Gjeodet/Topograf/

5. Një punësim mesatar i të paktën **5 (pesë)** personave, për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave të vërtetuar me;

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

6. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si: 1 (një) punonjës I pajisur me çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a. Çertifikatë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.
- b. Çertifikatë ISO 14001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.
- c. Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

**Shënim: Kandidati ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**



---

Shenim: Ne zbatim te pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...*”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara fazes së nënshkrimit të kontratës duhet t’i dergojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bejë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

### **Loti III: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i Emergjencës Civile Ura e Çerkezit”**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- Formulari i ofertës sipas Shtojcës 1*
- Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 8.**

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- a. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit financiare (2019, 2020) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në

rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

- b. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 2 (dy) viteve të fundit financiare (2019, 2020) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë sa 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).
- c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB). (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazes së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara nenshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).

## 2.3 Kapaciteti teknik:

### Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë mbikqyrjes, formularin / vërtetimin e vlerësimit për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes/ dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shenohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë mbikqyrjes, vërtetim për realizimin e shërbimit të mbikqyrjesku të shënohet vlera, koha si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shenohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

1.1 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit.

1.2 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçensë profesionale** për "Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi", e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi:

- N.P-1 (Punime gërmimi në tokë)
- N.P-4 (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)
- N.S-1 (Punime për prishjen e ndërtimeve)
- N.S-6 (Sinjalistika rrugore jo ndricuese)
- N.S-9 (Punime strukturore speciale)
- N.S-18 (Punime topogjeodezike)

